



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË  
 INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU  
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO

<p>QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë</p>	<p>GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health</p>	<p>VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva</p>
---	--	--

**Udhëzimi Administrativ 08/2007**  
**Për Shërbimin Spitalor në Kosovë**

**Ministria e Shëndetësisë,**

Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19, "Mbi Degën e Ekzekutivit të IPVQ-se në Kosovë", Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/15 "Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të IPVQ-se në Kosovë" Shtojca VI(i) që autorizon Ministrinë e Shëndetësisë për krijimin e politikës dhe zbatimin e ligjeve të një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor(ii) koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi (iii) vendos norma, standarde dhe nxjerr udhëzime administrative për sektorin e shëndetësisë,

Ligjin për Shëndetësi nr. 2004/04, me theks të veçantë në nenin 17, paragrafin(c);

Ligjin për Veprimtari Private në Shëndetësi me theks të veçantë në nenin 4 paragrafin 4.8;

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Kosovës, nxjerrë:

Udhëzimin Administrativ-Për shërbimin Spitalor në Kosovë

## Neni 1

### Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ, ka për qëllim të rregulloj organizimin, funksionimin dhe kontrollin në fushën e veprimtarisë shëndetësore spitalore në Kosovë, të përcaktoj kushtet minimale teknike-mjekësore, hapësirat, personelin dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore në spitale dhe procedurat e licencimit të institucioneve spitalore private.

## Neni 2

### Spitalet dhe llojet e tyre

- 2.1 Spitalet janë institucione shëndetësore të cilat ofrojnë kujdes shëndetësor stacionar, ambulantor, diagnostifikim, trajtim dhe rehabilitim të sëmurëve apo të lënduarve.
- 2.2 Spitalet në Kosovë janë publike dhe private.
- 2.3 Spitalet në Kosovë varësisht nga lloji i shërbimeve që ofrojnë janë:
  - a) spital i përgjithshëm,
  - b) spital ditor,
  - c) spital special.

## Neni 3

### Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ, shprehjet e përdorura kanë kuptim si më poshtë:

**Spitali ditor:** është institucion i veçantë apo pjesë e spitalit të përgjithshëm i aftësuar për të ofruar shërbime mjekësore dhe para mjekësore pacientëve të cilët janë pranuar për diagnostifikim, trajtim, rehabilitim ose lloj tjetër të kujdesit shëndetësor ditor brenda 24 orëve.

**Spitali i përgjithshëm:** është institucion i cili ofron kujdes shëndetësor 24-orësh me më së paku katër veprimtari të ndryshme shëndetësore dhe shërbimet përkrahëse.

**Spitali special:** është institucion shëndetësor i cili ofron shërbim shëndetësor konsultativ dhe stacionar në bazë të sëmundjeve të veçanta ose grup moshave të caktuara.

**Shtrati spitalor:** është njësi e kapacitetit spitalor.

Pajisjet e shënuara me yll (\*) nënkuptojnë ato pajisje të cilat nuk janë obligative për licencim të spitaleve.

## Neni 4

### Kushtet e përgjithshme të ambientit

- 4.1 Objekti duhet t'i plotësoj këto kushte:
- a) të jetë i vendosur në vendet me qasje të lehtë për komunitetin,
  - b) të jetë i vendosur në vendet të cilat i plotësojnë kriteret hapësinore dhe urbanistike,
  - c) të jetë e vendosur larg hekurudhave, depove të mallrave, kopshteve të fëmijëve, aeroporteve, zonave industriale dhe deponive të hedhurinave.
  - d) të jetë i mbrojtur nga zhurma, tymi, pluhuri, kundërmimi dhe vërshimet,
  - e) të siguroj dhe mirëmbaj ambient të sigurt për pacientët, personelin dhe publikun.
  - f) objektet private spitalore duhet të jenë në largësi së paku 1.5 km nga spitalet publike.

## Neni 5

### Kushtet e përgjithshme të objektit

- 5.1 Objekti në të cilin zhvillohet veprimtaria shëndetësore spitalore bashkë me objektet përcjellëse duhet të jenë të ndërtuara në përputhje me Ligjin për Ndërtim dhe Ligjet të cilat rregullojnë çështjet e ambientit.
- 5.2 Objektet duhet:
- a) të meremetohen dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt,
  - b) dyshemetë, muret dhe tavanet të jenë në harmoni me rregullat për objektet shëndetësore dhe që pastrohen lehtë, që kanë qëndrueshmëri ndaj temperaturave të larta dhe zjarrit,
  - c) dritaret të jenë të vendosura ashtu që të sigurojnë dritë të mjaftueshme dhe qasje të lehtë gjatë pastrimit të tyre,
  - d) hapësirat, rrugët dhe korridoret qarkulluese duhet të jenë të gjëra, të lira dhe çdo herë në dispozicion për lëvizje të lirë të pacientëve qoftë me shtretër, barelë, apo karroca.
- 5.3 Objekti spitalor duhet të siguroj:
- a) dyert e hyrje-daljeve për qasje të lehte dhe në përputhshmëri me standardet ndërtimore për institucionet shëndetësore,
  - b) dalje emergjente nga spitali,
  - c) ashensor dhe qasje të lehtë për pacient me shtrat dhe për personat me aftësi të kufizuara.

- 5.4 Të siguroj nriçim të mjaftueshem:
- a) për hapësirat me ndriçim të kufizuar natyror, duhet të siguroj ndriçim artificial me fuqi të caktuar të shprehur në luksa si :
    1. hapësirat kirurgjikale, njësitë e kujdesit intensiv dhe lindtore prej 500-1000 lluksa,
    2. për laboratorë 250-500 lluksa,
    3. për korridore dhe shkallë 40 lluksa,
    4. dritat e murit afër shtretërve të sëmurëve 70-100 lluksa.
  - b) të siguroj burime alternative për prodhimin e energjisë me kyçje automatike.
- 5.5 Të siguroj ventilim adekuat që i përgjigjet standardeve të definuar për institucionet shëndetësore:
- a) blloku operativ, lindtoret, hapësirat për kujdes intensiv duhet të kenë, ajër të kondicionuar dhe temperaturë optimale,
  - b) institucioni shëndetësor spitalor i cili ofron shërbime emergjente duhet të siguroj instalimin dhe stacionet qendrore për gazra.
- 5.6 Kushtet higjienike:
- a) institucioni shëndetësor spitalor shfrytëzon sistemin publik të furnizimit me ujë të pijshëm dhe siguron burime alternative të furnizimit,
  - b) mbeturinat e lëngëta të shkarkohen në sistem të kanalizimit publik,
  - c) mbeturinat e ngurta të mblidhen, trajtohen dhe të hedhen në pajtim me ligjet apo rregullat në zbatim,
  - d) hedhurinat spitalore të të gjitha formave të grumbullohen në enë të veçanta dhe të asgjësohen në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave mjekësore,
  - e) spitali dhe ndërtesat tjera shëndetësore duhet të sigurojnë dhe mirëmbajnë një ambient të pastër dhe estetik për pacientët, personelin dhe publikun,
  - f) hapësirat ku kryhen vizita të sëmurëve, nyja sanitare e të sëmurëve, nyja sanitare e personelit dhe dhomat e pacientëve duhet të kenë lavaman me ujë të nxehtë dhe të ftohtë, sapun të lëngët dhe terse të duarve për një përdorim,
  - g) tualetet duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë nga dhomat ose korridoret . Ato duhet të jenë të ndara për pacientë dhe personel meshkuj e femra,
  - h) spitali dhe objektet tjera përcjellëse duhet të sigurojnë ngrohje sipas standardeve teknike dhe ekologjike.
- 5.7 Mbrojtja e objektit nga zjarri:
- a) të ketë mjete për detektimin dhe mbrojtjen nga zjarri:
    1. alarme zjarri në mure,
    2. detektorë tymi në tavane.
  - b) pajisjet për shuarjen e zjarrit duhet të jenë të vendosura në vende të përshtatshme dhe strategjike.
- 5.8 Spitalet duhet të sigurojnë:
- a) vendparkim të mjaftueshëm, siguri për pacientët, personelin dhe pasurinë.
  - b) sistem efektiv grafik shenjëzimi i shoqëruar me mjete ndihmëse vizuale për informacione, orientim, drejtim, identifikim, ndalim, vërejtje dhe shënime zyrtare themelore për veprim optimal.

## Neni 6

### Radhitja e hapësirave spitalore

- 6.1 Hapësirat e spitalit duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën, funksionale dhe të radhitura sipas zonave:
- zona e parë: shërbimi i triazhës, i pacientëve të jashtëm, ambulator i emergjencës dhe administrativ,
  - zona e dytë: shërbimet diagnostike,
  - zona e tretë: trajtimi konservativ,
  - zona e katërt: trajtimet operative dhe kujdesit intensiv,
  - zona e pestë: shërbimet përkrahëse dhe teknike mund të gjenden edhe jashtë zonave të frekuentuara ose jashtë objektit spitalor.
- 6.2 Hapësirat për veprimtari shëndetësore duhet të kenë sipërfaqe prej:
- hapësirat e pritjes për spitale deri në 20 shtretër të jetë minimum 20 m<sup>2</sup> dhe për çdo 10 shtretër shtesë edhe 10 m<sup>2</sup>,
  - hapësira për informim 9 m<sup>2</sup>,
  - dhoma e pranimit për spitalet deri në 20 shtretër, minimum 20 m<sup>2</sup>,
  - hapësira për ordinancë specialiste 12 m<sup>2</sup>,
  - sallat operative së paku 20 m<sup>2</sup>,
  - njësitë e veprimtarive specialiste të degëve operative mund të kenë hapësira të përbashkëta të bllokut operativ, nëse këtë e mundësojnë kushtet teknike-ndërtimore dhe ato të hapësirës së komunikimit në objektin ku janë të vendosura,
  - hapësira ku ushqehen të sëmurët,
  - hapësirat për intervenime dhe për endoskopi 16 m<sup>2</sup>,
  - hapësirat për laborator biokimik hematologjik 64m<sup>2</sup> të parapara me rregullat për funksionim të laboratorit biokimik hematologjik,
  - hapësirat për ekzaminime radioimazherike sipas standardeve për objektet me destinim përdorimi të rrezeve jonizuese e jo jonizuese.
- 6.3 Hapësirat për pacientët:
- sipas grup moshave:
    - prej 0-2 vjeç nga 4,5 m<sup>2</sup> për shtrat,
    - prej 2-7 vjeç nga 5,5 m<sup>2</sup>,
    - mbi 7 vjeç nga 6,0 m<sup>2</sup>.
  - hapësirat për persona me aftësi të kufizuara 6,5 m<sup>2</sup>,
  - hapësirat për të sëmurët me sëmundje infektive 7 m<sup>2</sup>,
  - hapësirat për kujdes intensiv dhe izolim 6,5 m<sup>2</sup>.

## Neni 7

### Pajisjet dhe inventari

- 7.1 Pajisjet teknike-mjekësore duhet të sigurohen sipas standardeve të Unionit Evropian dhe të kenë certifikatë për servisim të rregullt.
- 7.2 Lista e pajisjeve do të përshkruhet në kuadër të kushteve të veçanta për spitalet.

7.3. Institucioni shëndetësor spitalor në hapësirat e veçanta për prematur, sallat të operacionit dhe kujdes intensiv duhet të siguroj pajisjet për debakterizim si:

- a) llamba germicid dhe llamba sterizol.

## Neni 8

### Personeli

- 8.1 Personeli shëndetësor duhet të jetë i kualifikuar dhe i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës.
- 8.2 Personeli shëndetësor për spital të përgjithshëm me 20 shtretër:
  - a) dy specialist për veprimtari përkatëse me orar të plotë pune,
  - b) katër infermier për veprimtari përkatëse me orar të plotë pune,
  - c) një punëtor për përkujdesje ndaj të sëmurëve në 20 shtretër,
  - d) për shërbimet e kujdestarisë duhet të sigurohet edhe 30% e kuadrit përkatës,
  - e) për spitalet e përgjithshme me më shumë se 20 shtretër, duhet të ketë:
    - 1 specialist nga lëmia përkatëse dhe 2 infermierë në çdo 10 shtretër.
- 8.3 Personeli shëndetësor për spital ditor me një veprimtari shëndetësore:
  - a) dy specialist të veprimtarisë përkatëse me orar të plotë pune,
  - b) katër infermier me orar të plotë pune,
  - c) për spitalet ditore me më shumë veprimtari shëndetësore:
    - 1. një specialist i lëmisë përkatëse për veprimtari shëndetësore,
    - 2. dy infermier për veprimtari shëndetësore.
  - e) personeli shëndetësor për spitalet ditore me më shumë se 5 përkatësisht 10 shtretër, duhet të ketë:
    - një specialist nga lëmia përkatëse dhe 2 infermierë në çdo 10 shtretër
- 8.4 Personeli shëndetësor për spital special me minimum 10 shtretër:
  - a) së paku dy specialist të veprimtarisë përkatëse me orar të plotë pune,
  - b) së paku katër infermier, me orar të plotë pune,
  - c) së paku një punëtor për përkujdesje ndaj të sëmurëve në 10 shtretër.
- 8.5 Për spitalet speciale me më shumë se 10 shtretër numri i personelit duhet të ketë:
  - a) në çdo pesë shtretër nga një specialist nga lëmia përkatëse dhe 2 infermierë,
  - b) për shërbimet e kujdestarisë duhet të sigurohet edhe 30% e kuadrit përkatës.
- 8.6 Personeli për kujdes intensiv me 10 shtretër:
  - a) për kujdesin dhe trajtimin intensiv katër specialist dhe njëzet infermier me përgatitje të lartë apo të mesme shkollore.

## Neni 9

### Kushtet e veçanta për spitalin e përgjithshëm

- 9.1 Është institucion shëndetësor i cili ofron kujdes shëndetësor 24 orësh, me së paku 20 shtretër, katër shërbime themelore shëndetësore dhe shërbimet përkrahëse.
  - a) sëmundje të brendshme,
  - b) kirurgji të përgjithshme,
  - c) gjinekologji me obstetrikë,

- d) pediatru,
- e) shërbimet përkrahëse.

## Neni 10

### Shërbimi i administratës për spitale

- 10.1 Hapësirat për shërbimin e administratës në spitale janë hapësira për:
- a) menaxhment,
  - b) pritje,
  - c) informim,
  - d) personel,
  - e) buxhet dhe financa,
  - f) cilësi të shërbimeve shëndetësore,
  - g) sistem informativ shëndetësor,
  - h) shërbime juridike,
  - i) arkivë,
  - j) konferenca, edukim dhe promovim shëndetësor dhe edukim të vazhdueshëm profesional të stafit.
- 10.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e administratës në spitale janë:
- a) dollapë,
  - b) karrige,
  - c) tavolina pune,
  - d) kompjuter,
  - e) fikës zjarri,
  - f) sirtar me kyç,
  - g) vitrina,
  - h) një gjenerator automatik,
  - i) frigorifer,
  - j) autoambulancë,
  - k) mjet transportues malli.
- 10.3 Personeli për shërbimin e administratës në spitale:
- a) zyrtar për cilësi të shërbimeve,
  - b) zyrtar për sistemit informativ shëndetësor,
  - c) zyrtar i personelit për burime njerëzore,
  - d) zyrtar për shërbime juridike,
  - e) zyrtar për buxhet e financa,
  - f) arkëtar,
  - g) arkivist,
  - h) zyrtar për shërbime përkrahëse,
  - i) një zyrtar mund të ketë maksimalisht dy funksione nëse këtë e lejon vëllimi i punëve dhe përgjegjësive dhe ligjet përkatëse,
  - j) orari e punës për zyrtar administrativ e përcakton spitali në bazë të kontratës së punës me punëmarrësin.

## Neni 11

### Shërbimet teknike dhe përkrahëse

- 11.1 Në kuadrin e shërbimeve teknike dhe përkrahëse bëjnë pjesë:
- barnatorja,
  - sterilizimi,
  - lavanteria,
  - sigurimi,
  - shërbimet servise: pastërti, autopark dhe parking,
  - bioinxhinjeria,
  - kuzhina.
- 11.2 Shërbimet përkrahëse përveç sterilizimit dhe barnatores mund:
- të themelohen nga vetë institucioni,
  - të sigurohen përmes formës së kontraktimit,
  - të themelohen si shërbime përkrahëse të përbashkëta mes dy spitaleve .

## Neni 12

### Barnatorja

- 12.1 Hapësirat për barnatore të spitalit janë hapësira për:
- dhënie e barërave 16 m<sup>2</sup>,
  - depo 30 m<sup>2</sup>,
  - administratë 9 m<sup>2</sup>,
  - laborator 8 m<sup>2</sup>,
  - ruajtjen e substancave lehtë të ndezshme 6 m<sup>2</sup>,
  - ruajtjen e barërave psikotrope dhe opiateve 4 m<sup>2</sup>,
  - nyjet sanitare.
- 12.2 Barnatorja e cila bënë përgatitjen e tretjeve për dhënie parenterale, duhet të ketë edhe hapësirat për:
- ruajtje të ambllazhës së papastër,
  - ekzaminim organoleptik dhe etiketim të produkteve,
  - ruajtje të produkteve të gatshme,
  - punë kontrolluese analitike,
  - përgatitje të tretjeve parenterale,
  - sterilizimin e produkteve të gatshme,
  - personelin e barnatores.
- 12.3 Inventari dhe pajisjet për barnatore të spitalit janë:
- mobilieri adekuate,
  - pajisje dhe enë laboratorike të nevojshme për përgatitjen e gatesave magjistrale dhe galenike sipas përshkrimeve të farmakopesë.



- 12.4 Personeli për barnatore të spitalit :
- a) një magjistër farmacie me orar të plotë pune,
  - b) dy teknikë të farmacisë për tetë orë pune,
  - c) një punëtor ndihmës.

### Neni 13

#### Sterilizimi qendror

- 13.1 Hapësirat për sterilizim qendror:
- a) paradhoma,
  - b) etiketim dhe evidentim,
  - c) komunikim përmes sportelit në mes dhomës për etiketim dhe pjesës sterile,
  - d) filtër (ndërrimi i personelit) për komunikim me pjesën sterile,
  - e) pjesa sterile,
  - f) dhënie përmes sportelit të materialit steril,
  - g) personeli,
  - h) nyja sanitare,
  - i) korridori për komunikim.
- 13.2 Pajisjet për sterilizim qendror:
- a) sterilizator me avull,
  - b) sterilizator i shpejtë\*,
  - c) sterilizator me nxehtësi\*.
- 13.3 Inventari për sterilizim qendror:
- a) Në dhomën për etiketim dhe evidentim:
    - 1.rafte,
    - 2.tavolinë,
    - 3.lavamanë.
  - b) Në pjesën jo sterile :
    - 1. karrocë për transportimin e materialit jo steril deri në autoklavë.
  - c) Në filtër:
    - 1. varëse.
  - d) Në pjesën sterile:
    - 1. karrocë,
    - 2. llamba ultraviolete,
    - 3. rafte.
  - e) Në dhomën e personelit:
    - 1. tavolinë,
    - 2. kompjuter.
- 13.4 Personeli për sterilizim qendror:
- a) dy infermier.

**Neni 14**  
**Shërbimet diagnostike**  
**Radiologjia me imazheri**

14.1 Hapësirat për kabinet të radiologjisë janë hapësirat për:

- a) pritore 9m<sup>2</sup>,
- b) zhveshjen e pacientëve të jetë e veçantë 2m<sup>2</sup>,
- c) tabelën komanduese 4m<sup>2</sup>,
- d) vendosje të aparatit të rëntgenit me një gyp 20 m<sup>2</sup>, për aparat rëntgeni me dy apo më shumë gypa rëntgenologjik 15m<sup>2</sup> për një gyp,
- e) aparat të rëntgenit për shërbime terapeutike 20 m<sup>2</sup>,
- f) aparat të rëntgenit me fuqi mbi 60 kv për inçizim të dhëmbëve dhe nofullave 16m<sup>2</sup>,
- g) zhvillim të filmave\*,
- h) ruajtjen e dokumentacionit.

14.2 Pajisjet dhe inventari për kabinet të radiologjisë :

- a) aparati i rëntgenit për incizim trefazor me 6-12 fokusues -drejtues të fortësisë 750 deri në 1000 mA dhe 125 deri në 150 kV gjegjësisht aparatën e rëntgenit për ndriçim rëntgenologjik krahas zmadhuesit elektronik dhe zinxhirit TV ose pajisje tjera diagnostike të cilat shfrytëzohen në rëntgenologji,
- b) tavolinë për ekzaminim rëntgenologjik,
- c) pajisje për dhomë të errët bashkë me pajisjet për zhvillim dhe tharje të filmave\*(R.O me kimi të lëngët),
- d) negatoskop,
- e) dorëzat e plumbit të thurura për ekzaminim,
- f) syza dhe përparëse të plumbit,
- g) dozimetrit filmik dhe mbrojtjen përkatëse të plumbit për pacientin,
- h) mjetet për dhënien e preparateve-kontrasteve me rrugë intravaskulare, orale dhe rektale,
- i) aparatën për dhënie të oksigjenit,
- j) kompleti për antishok terapi,
- k) aparat ultrazëri\*,
- l) CT-skaner \* ,
- m) rezonancë magnetike \* ,
- n) aparat elektrokardiografi tre kanalesh\*,
- o) spirograf\*,
- p) oscilograf \* ,
- q) aparaturë për ergometrin \* ,
- r) aparat për angiokardiografi dy drejtimesh me pajisjet përkatëse për kateterizim\*,
- s) karrige lëvizëse dhe tavolina së paku 2 copë,
- t) stetoskop,
- u) tensimetër.

14.3 Personeli për kabinet të radiologjisë:

- a) specialist i radiologjisë,

- b) teknik i radiologjisë ose infermier i aftësuar dhe licencuar për punë në radiologji.

14.4 Shërbimet tjera të imazherisë duhet të jenë në përputhje me udhëzimin administrativ Nr.03/2007 Për aplikimin e rrezeve jonizuese dhe jo jonizuese në shëndetësi.

**Neni 15**  
**Shërbimet diagnostike**  
**Laboratori biokimik-hematologjik**

15.1 Hapësirat për laboratorin biokimik hematologjik janë hapësirat për:

- a) pritore 18 m<sup>2</sup>,
- b) pranimin e pacientëve dhe marrjen e materialit 12 m<sup>2</sup>,
- c) analiza laboratorike 12m<sup>2</sup>,
- d) përgatitjen e materialit 12 m<sup>2</sup>,
- e) larje, terje dhe sterilizim të enëve së paku 10 m<sup>2</sup>,
- f) udhëheqësin e laboratorit dhe kujdestarinë,
- g) punë administrative 6 m<sup>2</sup>,
- h) nyje sanitare për pacientë dhe personel.

15.2 Pajisjet për laboratorin biokimik hematologjik:

- a) garniturë e mobileve laboratorike,
- b) karrige për pacientin dhe shtrati për marrjen e materialit,
- c) sterilizator,autoklavë\*,
- d) frigorifer,
- e) termostati,
- f) dejonizatori\*,
- g) peshore analitike,
- h) mikroskopi,
- i) centrifugat laboratorike,
- j) llamba me flakë,
- k) numëruesi hematologjik,
- l) spektrofotometri,
- m) analizatorin biokimik me njësi të elektroliteve,
- n) osmometër,
- o) aparat për statusin acidobazik,
- p) aparat për elektroforez,
- q) nefelometër,
- r) analizator imunokimik,(EIA,LIA,FPIA),
- s) koagulometër,
- t) viskozimetër,
- u) centrifug me ftohje,
- v) banjë ujore.

15.3 Personeli për laboratorin biokimik hematologjik:

- a) specialist i biokimisë klinike,

- b) dy teknik laboratorori.

**Neni 16**  
**Shërbimet diagnostike**  
**Laboratori mikrobiologjik**

16.1 Hapësirat për laboratorin mikrobiologjik janë hapësirat për:

- a) pacientë spitalor  $15\text{m}^2$ ,
- b) marrjen e materialit  $10\text{m}^2$ ,
- c) marrjen e materialit dhe dhënien e rezultateve  $9\text{m}^2$ ,
- d) hapësira për dignostifikim  $40\text{m}^2$ ,
- e) nyja sanitare për pacient  $5\text{m}^2$ ,
- f) nyja sanitare me tush për personelin  $10\text{m}^2$ ,
- g) dekomantim të materialit infektues  $9\text{m}^2$ ,
- h) larjen dhe sterilizimin e enëve laboratorike  $9\text{m}^2$ ,
- i) përgatitjen e terreneve ushqyese  $15\text{m}^2$ ,
- j) të ushqyerit e terreneve ushqyese rezervë, reagensëve dhe materialit tjetër  $6\text{m}^2$ ,
- k) gardërobë  $10\text{m}^2$ ,
- l) udhëheqësin e laboratoriumit  $15\text{m}^2$ .

16.2 Pajisjet dhe inventari për laboratorin mikrobiologjik:

- a) pinceta,
- b) pipeta,
- c) dispensor për antibiotik,
- d) thjerrëz zmadhuese laboratorike,
- e) qelqet laboratorik,
- f) enë plastike,
- g) llamba me flak,
- h) ftohësi  $+4\text{ }^\circ\text{C}$ ,
- i) ngrirës  $-20\text{ }^\circ\text{C}$ ,
- j) termostat  $+37\text{ }^\circ\text{C}$ ,
- k) sterilizator të thatë,
- l) autoklavë,
- m) mikroskop binokular me imerzion dhe sistem të ndriçimit të thatë,
- n) centrifug laboratorike e tavolinës,
- o) peshore analitike dhe e thjeshtë,
- p) enët për kultivimin e bakteve anaerobe apo termostat anaerob,
- q) pajisje për serologji,
- r) aparati për përpunimin automatik të preparateve primare sterile,
- s) kadë ujore,
- t) pehametër,
- u) denzitometri,
- v) kabinetet e siguruara për punë,
- w) ekshautor për përgatitjen e preparateve parazitologjie,
- x) tavolinat laboratorike dhe mobilet tjera,
- y) fshesa për enët laboratorike.

16.3 Personeli për laboratorin mikrobiologjik :

- a) një mjek specialist i mikrobiologjisë,
- b) dy teknik laboratorant.

**Neni 17**  
**Shërbimet diagnostike**  
**Laboratori i citologjisë**

17.1 Hapësirat për laboratorin e citologjisë:

- a) përgatitjen dhe ngjyrosjen e preparateve, të fituara citologjike 6m<sup>2</sup>,
- b) punën e një mjeku me mikroskop 9m<sup>2</sup>, e për më shumë mjekë duhet shtuar nga 4m<sup>2</sup> për secilin,
- c) arkivim dhe administrim 6m<sup>2</sup>,
- d) materialet lehtë të ndezshme 2.5 m<sup>2</sup>,
- e) nyjën sanitare për të punësuarit.

17.2 Veprimtaria e përzier citologjike në të cilën përpos analizës së materialit të pranuar, citologu e merr materialin nga të sëmurët në mënyrë të pavarur në ordinancën e citologjisë, duhen edhe hapësirat për :

- a) pritore 9m<sup>2</sup>,
- b) punksion dhe ekzaminim te pacientit 12m<sup>2</sup> \*.

17.3 Pajisjet dhe inventari për laboratorin e citologjisë:

- a) pajisjet për ventilim aktiv,
- b) pajisjet dhe reagensët për ngjyrosje,
- c) centrifugë,
- d) digestor,
- e) mikroskop binokular,
- f) qelq mikroskopi dhe qelq mbulues,
- g) gota -kontejner për urinë,
- h) pllakëzat e Petrit dhe enët tjera të nevojshme për laborator,
- i) orën laboratorike,
- j) frigoriferi,
- k) sterilizatori,
- l) dollapi metalik për materialet lehtë të ndezshme,
- m) dollapi për arkivim të rezultateve dhe kartotekë/ evidencë kompjuterike,
- n) dollapi për arkivim të preparateve,
- o) tavolinë punë për pajisjet e punksionit,
- p) pajisje për dezinfektim,
- q) pajisjet për punksion,
- r) pajisjet për anestezion lokal,
- s) pajisjet për ofrim të ndihmës emergjente.

17.4 Personeli për laboratorin e citologjisë:

- a) një mjek specialist të patologjisë,
- b) një teknik laborant.

**Neni 18**  
**Shërbimet diagnostike**  
**Laboratori i patologjisë**

- 18.1 Hapësirat për laboratorin e patologjisë:
- a) marrjen, procedimin dhe mbulimin e preparateve 30m<sup>2</sup>,
  - b) prerjen e preparateve 40m<sup>2</sup>,
  - c) laborator histopatologjik-ngjyrimi dhe të ngjashme 23 m<sup>2</sup>,
  - d) zyrën laboratorike 20 m<sup>2</sup>,
  - e) mjekun 9m<sup>2</sup>,
  - f) asistenten 8 m<sup>2</sup>,
  - g) ruajtjen e përgatitjen kemikaljeve 13m<sup>2</sup> dhe për vendosjen e qelqeve dhe bllokave të parafinës 7.5 m<sup>2</sup>,
  - h) korridore e dhoma pushimi,
  - i) sanitari 34 m<sup>2</sup>, e ndarë për kriostat 6m<sup>2</sup>,
  - j) ngjyrimet imunohistokimike 10m<sup>2</sup>,
  - k) takime/komunikime 10 m<sup>2</sup>.
- 18.2 Pajisjet dhe inventari për laboratorin e patologjisë:
- a) mikroskopi binokular,
  - b) kriostat, mikrotomi së paku tre,
  - c) frigorifer,
  - d) reagensët e nevojshëm-fiksativë,
  - e) ngjyrat,
  - f) alkooli,
  - g) ksilol dhe të ngjashme,
  - h) enët laboratorike,
  - i) pipeta,
  - j) kade të ujit -së paku tre,
  - k) pajisje kirurgjikale për marrjen e indit,
  - l) qelqet dhe qelqi mbulues,
  - m) ora laboratorike,
  - n) polica për arkivimin e bllokave të parafinës,
  - o) termostati,
  - p) enët për ngjyrim në hapësirën me ventilim aktiv,
  - q) kompjuteri për futjen e rezultateve,
  - r) ormani për arkivimin e preparateve,
  - s) ormani për arkivimin e rezultateve,
  - t) ormani metalik për materiale lehtë të ndezshme,
  - u) tavolinë e punës me ventilim aktiv të hapësirës për marrjen e materialit,
  - v) tavolina për mbulimin e indeve me parafinë të lëngët.
- 18.3 Personeli për laboratorin e patologjisë :
- a) një specialist i patologjisë,
  - b) një teknik laborant.

## Neni 19

### Shërbimi i transfuzionit të gjakut

- 19.1 Shërbimet e transfuzionit në spitale të kryhen në bazë të Ligjit mbi transfuzionin e gjakut.
- 19.2 Hapësirat për shërbimin e transfuzionit të gjakut janë hapësirat për:
- laboratorin për diagnostifikim imunohematologjik 20 m<sup>2</sup>,
  - laboratori për përcaktimin e grupeve të gjakut dhe reksioneve hemolitike 20m<sup>2</sup>,
  - hapësira për marrjen e gjakut 10m<sup>2</sup>,
  - ruajtjen dhe ndarjen e gjakut dhe produkteve të gjakut 12m<sup>2</sup>,
  - dhënjen e gjakut, produkteve të tij dhe të dhënave laboratorike,
  - larjen e pajisjeve laboratorike,
  - deponimin e materialeve shpenzuese 20 m<sup>2</sup>,
  - personel,
  - nyjet sanitare për personel dhe pacientë,
  - lavaman me ujë të ngrohtë, sapun të lënget dhe peshqir për një përdorim.
- 19.3 Pajisjet për transfuzionin e gjakut:
- centrifuga,
  - aparati për përcaktimin automatik të grupeve të gjakut dhe të reaksioneve hemolitike,
  - koagulometër,
  - vakum Pompë\*,
  - procesor Elisa\*,
  - siler auto,
  - centrifugë për ftohje,
  - analizator, numrues hematologjik,
  - trombelastograf\*,
  - frigorifer i destinuar për transfuzion ,
  - frigorifer me ngrirje të thellë së paku 25° C,
  - frigorifer transporti me temperatur të kontrolluar dhe alarm,
  - pajisje specifike për diagnostifikim imunohematologjik,
  - termostat në 37°C ,
  - aparati për ngrirje të plazmës dhe agjikator për trombocite me temperaturë të kontrolluar,
  - aparati për shkrirjen e plazmës,
  - agjikatorin për trombocite me temperaturë të kontrolluar,
  - aparati për përcaktimin e shpejtë të hemoglobines së dhënësit,
  - tavolinë laminare,
  - shtrat për marrjen e gjakut.
- 19.4 Personeli për transfuzionin e gjakut :
- një mjek specialist të transfuzionit,
  - një teknik laborant,
  - një infermier.
- 19.5 Spitalet private furnizohen me gjak dhe produkte të gjakut në bazë të ligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe produkteve të tij dhe akteve nenligjore.

## Neni 20

### Shërbimi i ambulancave specialistike për pacientët jashtë spitalor

- 20.1 Hapësira për ambulancën specialistike për pacientet e jashtëm:
- pritore 9 m<sup>2</sup> dhe për çdo ambulancë shtesë edhe 4 m<sup>2</sup>,
  - ordinancat me lavaman 12 m<sup>2</sup>,
  - hapësira për konsultim me lavaman 9 m<sup>2</sup>,
  - nyje sanitare me lavamanë.
- 20.2 Pajisjet dhe Inventari par ambulancën specialistike për pacientet e jashtëm:
- dollapi metalik me çelës për kartela shëndetësore të pacientëve,
  - tavolinë e punës për mjekun,
  - tavolinë e punës për infermierë,
  - karrigë lëvizëse me rregullues të lartësisë për mjekun dhe infermier,
  - karrigë për pacientin,
  - karrigë lëvizëse me fileto pa mbështetëse për ekzaminim të pacientit,
  - varëse garderobe,
  - telefon,
  - tensimetër me zhivë dhe me manzheta me gjerësi të ndryshme,
  - krevat otoman për ekzaminim të pacientit,
  - paravan,
  - dollap për instrumente dhe barëra,
  - tavolinë për instrumente,
  - termometra dy copë,
  - fonendoskop ndëgjuese,
  - shpatulla për ekzaminim të grykës për një përdorim dhe plahte për një përdorim,
  - dorëza për një përdorim,
  - komplet të barërave për terapi të shokut anafilaktik dhe barërave ampulare në përputhje me nevojat e popullsisë të cilës i ofrohet kujdesi shëndetësor,
  - enët plastike për mbeturina mjekësore,
  - enët për mbeturina tjera,
  - kompjuteri dhe tavolina për kompjuter.
- 20.3 Personeli për ambulancën specialistike për pacientët e jashtëm:
- një mjek specialist të lëmisë përkatëse për secilin shërbim,
  - një infermier.



## Neni 21

### Shërbimet e morgut

- 21.1 Institucioni shëndetësor spitalor publik është i obliguar të ketë shërbimet e morgut.
- 21.2 Institucioni shëndetësor spitalor privat, duhet të ketë hapësirën e veçantë për vendosjen e kufomave, ndërsa shërbimet e morgut duhet ti ketë të kontraktuara me institucionet shëndetësore publike.
- 21.3 Shërbimet e morgut sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe mjekësisë ligjore përcaktohen në bazë të Ligjit për Shëndetësi dhe akteve ligjore në fuqi.

## Neni 22

### Shërbimi për sëmundje të brendshme

- 22.1 Hapësirat përveç kushteve të parapara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:
  - a) dhomën për aparaturë diagnostike-terapeutike.
- 22.2 Pajisjet dhe inventari për sëmundjet e brendshme:
  - a) Në dhomën e pranimit, përveç pajisjeve të përcaktuara në nenin 20.2 të këtij udhëzimi, duhet të ketë edhe:
    - 1. karrocë për transport të pacientëve në pozitë të ulur,
    - 2. karrocë për transport të pacientëve në pozitë të shtrirë.
  - b) Në pjesën stacionare diagnostifikim, trajtim dhe kujdes intensiv:
    - 1. aparat për EKG, trekanalësh,
    - 2. spirometër\*,
    - 3. aparat për përcaktim automatik të pasqyrës së gjakut,
    - 4. glikometër,
    - 5. ambu balon me maskë,
    - 6. defibrilator me monitor elektrokardiografik,
    - 7. monitor për EKG, tension arterial dhe puls me oksimetër dhe kapnokgraf,
    - 8. pompa infuzive,
    - 9. aparat respiratori me presion për inhalim dhe oksigjenoterapi,
    - 10. vakum aspiratori elektrik,
    - 11. kompleti për intubim endotracheal,
    - 12. shtrat për pacient,
    - 13. shtrat special për pacient,
    - 14. orman,
    - 15. ormanë për materiale sanitare dhe barëra,
    - 16. orman për instrumente,
    - 17. otoman për ekzaminim,
    - 18. tavolinë pune,
    - 19. dy karrika,
    - 20. paravan,
    - 21. frigorifer,
    - 22. sterilizator i thatë\*,
    - 23. urokateterë për një përdorim diamettrash të ndryshëm,

- 24. pajisjen për punksion dhe drenim torakal,
- 25. irigator,
- 26. pajisje për lavazh të lukthit,
- 27. negatoskop,
- 28. peshore me matëse të lartësisë.

22.3 Personeli për sëmundjet e brendshme :

- a) të jetë në përputhje me nenin 8.2 të këtij udhëzimi administrativ.

### Neni 23

#### Shërbimi për sëmundje të mushkërive

- 23.1 Hapësirat përveç kushteve të parapara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:
  - a) në dhomën për aparaturë diagnostike-terapeutike.
- 23.2 Pajisjet për sëmundjet e mushkërive duhet të përfshijnë:
  - a) Në dhomën e pranimit pajisjet duhet të jenë si në nenin 20.2 të këtij Udhëzimi Administrativ,
  - b) Në pjesën stacionare:
    - 1. EKG tre kanalësh portabil,
    - 2. sterilizator të thatë,
    - 3. defibrilator,
    - 4. analizator të gazrave,
    - 5. inhalator,
    - 6. sistem për oksigjenoterapi të kontinuar,
    - 7. ergomentrin për ekzaminim të funksionit të mushkërive,
    - 8. shtrat për drenazh,
    - 9. spirometër,
    - 10. monitor për EKG, tension arterial dhe puls me oksimetër dhe kapnograf,
    - 11. pompa infuzive,
    - 12. pajisje për punksion pleural,
    - 13. inhalator ultrasonik,
    - 14. autokllav;
    - 15. bronkoskop fiberoptik,
    - 16. mikroskop binokular,
    - 17. pajisje për identifikimin e bacileve të kohut,
    - 18. pajisje të tjera diagnostike janë të njëjta si për spitalin e përgjithshëm.
- 23.3 Personeli për sëmundjet e brendshme:
  - a) të jetë në përputhje me nenin 8 .2 të këtij udhëzimi administrativ.

### Neni 24

#### Shërbimi i dermatovenerologjisë

- 24.1 Hapësirat përveç kushteve të parapara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:
  - a) hapësirën për ekzaminim mikroskopik.

- 24.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e dermatovenerologjisë përveç ato të përcaktuara në nenin 20.2 përfshin edhe:
- a) Në dhomën e pranimit:
1. tavolinë pune,
  2. dy karrika,
  3. otoman,
  4. reflektor në shtyllë,
  5. shpatulla,
  6. llupa,
  7. tensimetër,
  8. stetoskop,
  9. tavolinë gjinekologjike.
- b) Në pjesën stacionare:
1. spekulume vagjinale,
  2. paanë cervikal,
  3. mikroskop,
  4. termokauter,
  5. kohleja,
  6. gjilpërat për punksion,
  7. pincetat për epilacion,
  8. gërshërë te drejta dhe të lakuara,
  9. skalperë,
  10. lanceta,
  11. bombola me azot të lëngshëm,
  12. pajisjen për marrjen e materialit për analiza citologjike dhe mikrobiologjike me sistem te mbyllur.
- 24.3 Personeli për shërbimin e dermatovenerologjisë:
- a) një mjek specialist të dermatovenerologjisë,
  - b) një infermier,
  - c) një punëtor për përkujdesje të sëmurëve në 20 pacient me orar të plotë pune.

## Neni 25

### Shërbimi i dializës

- 25.1 Hapësirat për shërbimin e dializës, duhet të kenë hapësira për:
- a) dializë me 30m<sup>2</sup> për një vend për dializë,
  - b) hapësirat të ndara për dializë për pacient negativ, HBS pozitiv, HCV poz dhe HIV poz,

- c) përgatitjen e ujit me osmozë kthyesë 16 m<sup>2</sup>,
- d) përgatitjen e pacientit për dializë peritoneale 10 m<sup>2</sup>,
- e) dijalizë peritoneale 20 m<sup>2</sup>,
- f) përgatitje dhe sterilizim,
- g) pastrimin e rrobave dhe materialit sanitar,
- h) rroba të papastru dhe largimin e materialit shpenzues,
- i) servisim dhe vendosjen e pajisjeve rezervë për dijalizë,
- j) depo dore të materialit shpenzues në lidhje me qendrën,
- k) materialin shpenzues,
- l) udhëheqësin e qendrës,
- m) ekzaminimin e pacientëve,
- n) personel shëndetësor dhe dokumentacion,
- o) personel shëndetësor,
- p) pushim të sëmurëve,
- q) garderobë,
- r) kuzhinë,
- s) nyjet sanitare për personel dhe pacientë,
- t) lavaman me ujë të ngrohtë dhe sapun të lëngët dhe terëse për një përdorim,
- u) banjo për larje për personel dhe pacientë.

25.2 Pajisjet për shërbimin e dializës përfshijnë:

- a) aparate për dijalizë,
- b) aparate rezervë për dijalizë i veçant për të sëmurit HBS/Hiv-negativ dhe HBS/Hiv-pozitiv,
- c) pajisje për përgatitjen e ujit i cili i përgjigjet standardeve të ujit për hemodijalizë,
- d) EKG portabile,
- e) aspirator,
- f) defibrilator me monitor,
- g) sterilizator,
- h) kompleti për reanimim,
- i) oksigjen,
- j) frigorifer,
- k) pajisje për përcaktimin e pasqyrës së gjakut dhe elektroliteve,
- l) peshore mekanike apo digitale,
- m) shtrat apo fotele për hemodijalizë.

25.3 Personeli për shërbimin e dializës duhet të ketë:

- a) një mjek në 40 pacientë me dijalizë kronike në spitalin e përgjithshëm, nefrolog, specialist i sëmundjeve të brendshme apo specialist i pediatriisë i aftësuar për dijalizë,
- b) një infermier, me edukim shtesë për dijalizë në katër pacient,
- c) një infermier në dhjetë pacient të dijaliza peritoneal.

## Neni 26

### Shërbimi i sëmundjeve ngjitëse

- 26.1 Sëmundjet karantinoze duhet të trajtohen në harmoni me Ligjin për Sëmundjet Ngjitëse.
- 26.2 Hapësirat, përveç kushteve të parapara në nenin 5 dhe neni 6 duhet të ketë edhe:
- a) hapësirën për analiza laboratorike dhe marrjen e materialeve,
  - b) ambulancën me pritje për ekzaminim të pacientëve infektiv,
  - c) dhomë izoluese me qasje të veçantë.
- 26.3 Pajisja dhe inventari për shërbimin e sëmundjeve ngjitëse, përveç pajisjeve të paraparë me nenin 19.2 duhet të ketë edhe:
- a) Në dhomën e pranimit që përfshin:
    1. tavolina pune,
    2. dy karrika,
    3. otoman për ekzaminim,
    4. reflektor me përforcues,
    5. stetoskop,
    6. tensiometër,
    7. çekiç neurologjik,
    8. negatoskop.
  - b) Në pjesën stacionare që përfshin:
    1. sterilizator i thatë,
    2. aparatën e EKG-së trekanalësh,
    3. monitor për EKG, tension arterial, puls me oksimetër dhe kanograf,
    4. negatoskopin,
    5. vakum aspiratori elektrik,
    6. pompë infuzive,
    7. ezofag-gastro-duodenoskop,
    8. kolono-sigmoido-rektoskop,
    9. laparaskop,
    10. mikroskop binokular me ndriqim,
    11. frigorifer,
    12. llampë baktericide,
    13. defibrilator,
    14. kompleti për intubim endotracheal,
    15. EEG me poligraf,
    16. pajisje për biopsinë e mëlqisë,
    17. karrocë për barëra,
    18. peshore me matës të lartësisë,
    19. pajisje për lavash të lukthit,
    20. irigator,

- 21. pajisjen për punksion lumbal,
  - 22. pajisje për marrjen e materialit për analiza hematologjike, bakteriologjike, parazitologjike, citologjike dhe ekzaminime tjera.
- 26.4 Personeli për shërbimin e sëmundjeve ngjitëse:
- a) të jetë në përputhje me nenin 8.2 të këtij udhëzimi administrativ.

## Neni 27

### Shërbimi i neurologjisë

- 27.1 Hapësira për shërbimin e neurologjisë, përveç kushteve të parapara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:
- a) hapësirën për pajisje të EEG-së.
- 27.2 Pajisja dhe inventari për shërbimin e neurologjisë, përveç pajisjeve të parapara me nenin 20.2 duhet të ketë edhe:
- a) Në dhomën e pranimit:
    1. tavolina pune,
    2. dy karrika,
    3. otoman për ekzaminim,
    4. reflektor me përforcues,
    5. stetoskop,
    6. aparat për matjen e tension arterial,
    7. çekiç neurologjik,
    8. negatoskop,
    9. EKG tre kanalshe\*;
    10. EKG me poligraf\*.
  - b) Në pjesën stacionare, diagnostifikim, trajtim dhe kujdes:
    1. elektromiograf me potencial të evocuar,
    2. reoencefalograf,
    3. vakum aspirator elektrik,
    4. aparat për inhalim dhe oksigjenoterapi,
    5. sterilizator te thatë,
    6. monitor për EKG, tension arterial dhe pulsoksimetër,
    7. elektrokardiograf trekanalësh,
    8. defibrilator,
    9. pompë infuzive,
    10. karrocë për barëra,
    11. pirunin akustik për ekzaminim të ndjeshmërisë së vibracioneve,
    12. oftalmoskop,
    13. thjerrëz zmadhuese,
    14. bateri-llamp dore,
    15. çekanin për reflekse,

10. gjilpëren për testim,
11. pajisjen për punkSION lumbal,
12. pajisjen për anesteziON lokal dhe pajisjen për marrjen e materialit për ekzaminime mjekësore-biokimike, mikrobiologjike dhe citologjike,
13. aparat ultrazëri dopler me sondë për ekzaminim të enëve të gjakut të qafës\*,
14. aparat ultrazëri kolor dopler me sondë për ekzaminim të enëve të gjakut të kokës-dopleri transkranial\*,
15. ortoraiter\*,
16. aparat për matjen e potencialit të evocuar\*,
17. elektroencefalograf\*,
18. biomikroskop me tonometri aplanative\*,
19. keratometër sipas Javelit\*,
20. perimetër sipas Goldmanit\*.

27.3 Personeli për shërbimin e neurologjisë:

- a) Të jetë në përputhje me nenin 8.2 të këtij Udhëzimi Administrativ si dhe të ketë:
  1. një person për përkujdesje në çdo katër shtretër,
  2. një fizioterapeut të lartë për çdo dhjetë shtretër, me orar të plotë,
  3. një specialist fiziatër për çdo njëzet shtretër.

## Neni 28

### Shërbimi i psikiatrisë

- 28.1 Hapësira për shërbimin e psikiatrisë, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 5 dhe 6, duhet të ketë edhe:
  - a) dyer dhe dritare me sistem të mbyllur dhe rezistent ndaj thyerjeve,
  - b) për punë me grupe të vogla 20m<sup>2</sup> dhe për punë me grupe të mëdha 40m<sup>2</sup>,
  - c) në njësinë e psikiatrisë emergjente duhet siguruar së paku dy dhoma për destinim të veçantë, të mbikëqyrura, të monitoruara dhe të siguruara.
- 28.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e psikiatrisë përveç pajisjeve të përcaktuara me nenin 20.2 duhet të ketë edhe:
  - a) Në dhomën e pranimit:
    1. tavoline pune,
    2. dy karrika,
    3. otoman për ekzaminim,
    4. reflektor me përforcues,
    5. stetoskop,
    6. aparat për matjen e tensionit arterial,
    7. çekiç neurologjik,
    8. negatoskop.

b) Në pjesën stacionare, dignostifikim, trajtim dhe kujdes:

1. EKG- trekanalësh,
2. aparat për përcaktimin e neuroleptikëve në lëngun indor,
3. EEG me Poligraf,
4. EEG me potencial të evocuar\*,
5. EEG portabëldigjitale\*;
6. videosistem\*,
7. pajisje për përcaktimin e barërave dhe të substancave në indet e lëngëta\*,
8. respirator\*,
9. vakumaspirator elektrik\*;
10. defibrilator;
11. aparat oksigjeni me pajisje.

28.3 Personeli për shërbimin e psikiatrisë:

a) Të jetë në përputhje me nenin 8.2 të këtij udhëzimi administrativ si dhe të ketë edhe:

1. një person për përkujdesje në pesë shtretër,
2. një fizioterapeut i lartë në tridhjetë shtretër,
3. një terapeut pune (preokupuese) në pesëmbëdhjetë shtretër,
4. personel të aftësuar për siguri fizike për emergjenca dhe kujdes intensiv psikiatrik.

## Neni 29

### Shërbimi i pediatriisë

29.1 Hapësira për shërbimin e pediatriisë, përveç kushteve të kërkuara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:

- a) kuzhinën e qumështit me lavaman,
- b) kuzhinën demonstruese për edukim të nënave,
- c) sterilizim,
- d) dhomën për përgatitje dhe ruajtje të ushqimit të gatshëm,
- e) hapësirën për nënat gjidhënëse,
- f) vaskat lëvizëse për larje, një vaskë për çdo gjashtë shtretër,
- g) dhomën për lojë dhe qëndrim ditor të fëmijëve.

29.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e pediatriisë:

a) Në dhomën e pranimit, përveç pajisjeve të përcaktuara në nenin 20.2 të këtij udhëzimi, duhet të ketë edhe:

1. karroca për transport të pacientëve në pozitë të ulur,
2. karroca për transport të pacientëve në pozitë të shtrirë.

b) Në pjesën stacionare, dignostifikim, trajtim dhe kujdes intensiv:

1. aparat për EKG,



2. monitor për EKG, tension arterial, puls me oksimetër dhe kapnograf,
3. pompë infuzive,
4. vakum aspirator elektrik,
5. analizator gazrash,
6. puls oksimetër,
7. llambë për fototerapi,
8. inkubator për kujdes standard,
9. defibrilator për fëmijë,
10. burim i oksigjenit me pajisje,
11. pajisje për intervenime të vogla kirurgjike,
12. sterilizator të thatë,
13. frigorifer,
14. karrocë për barëra,
15. kompletin e tubusave për intubim për fëmijë,
16. manzheta dimensionesh të ndryshme, për matjen e të tension arterial,
17. mbajtëse për infuzione,
18. shtrat për të sëmurë të mëdhenj,
19. shtrat për të sëmurë të vegjël,
20. shtrat për të porsalindur,
21. inkubator fiks,
22. inkubator portabil për transport,
23. sistem për sterilizim,
24. tavolinë për mbështjelljen e foshnjës,
25. stetoskopin e përshtatshëm për fëmijë,
26. peshoren për foshnje, me matës të gjatësisë,
27. peshoren për fëmijë më të rritur me matësin të gjatësisë,
28. otoskopin,
29. oftalmoskopin,
30. sisteme bebi e për dhënie të infuzioneve,
31. negatoskop,
32. aparat për dhënie të oksigjenit dhe bombole me oksigjen.

29.3 Personeli për shërbimin e pediatrikë:

- a) të jetë në përputhje me nenin 8.2 të këtij udhëzimi administrativ.

## Neni 30

### Shërbimi i gjinekologjisë me obstetrikë

- 30.1 Hapësira për shërbimin e gjinekologjisë me obstetri, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 5 dhe 6 duhet të ketë edhe:
- a) Shërbimi i gjinekologjisë:
    1. dhoma për ekzaminim dhe intervenim,
    2. dhoma për pacientë.
  - b) Shërbimi i Obstetrikës:
    1. dhoma për pranim,
    2. paralindorja,
    3. lindorja,
    4. dhoma e lehonave me të porsalindurin,
    5. hapësirën për të lindurit para kohe (prematurët),
    6. hapësirën për të porsalindurit e sëmurë,
    7. një lindtore me pajisje është e mjaftueshme për 500 lindje në vit, ndërsa për çdo 500 lindje më shumë nevojitet edhe një lindtore me pajisje,
    8. për lindoret /sallat e lindjes/ me më shumë se 1500 lindje në vit, duhet siguruar edhe njësin e kujdesit intensiv neonatal me pajisje përkatëse,
    9. gjithashtu duhet të ketë edhe sallën operative si në nenin 31.1 të këtij udhëzimi administrativ.
- 30.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e gjinekologjisë me obstetrikë:
- a) Në dhomën e pranimit përveç pajisjeve të përcaktuara në nenin 20.2 duhet të ketë edhe:
    1. tavolinë gjinekologjike,
    2. reflektor,
    3. kolposkop,
    4. aparat për inhalim dhe oksigjenoterapi,
    5. karroca për transport për paciente të ulur,
    6. karroca për transport për pacient të shtrirë,
    7. dyshkallësh.
  - b) Në pjesën stacionare:
    1. katetër urinar për një përdorim madhësish të ndryshme,
    2. spekulum vaginal të përparme dhe të pasme,
    3. pinca dhëmbëzuese për qafën e mitrës,
    4. instrumente për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-gjinekologjike, vetëm me anestezi lokal,
    5. stetoskop druri,
    6. dilatator (HEGAR),

7. kërcëza gjinekologjike,
  8. peshore, me metër pëlhere,
  9. irigator,
  10. gjilpërmbajtës,
  11. gjilpëra dhe penj kirurgjik,
  12. gërsër kirurgjike,
  13. skalperë,
  14. kompresa,
  15. shtrat për vizita obstetrike,
  16. burim drite artificial për ekzaminim,
  17. spekulum vaginal,
  18. mikroskop,
  19. pajisje për marrjen e strishove vagjinale dhe cervikale,
  20. pajisjen për anestezi lokal,
  21. pelvimetër,
  22. fetoskop,
  23. pajisjen për marrjen e strishos sipas papanikollaut dhe përcaktimit të shkallës së pastërtisë së gruas shtatzënë,
  24. pajisjen për fiksion dhe dërgim të materialit në ekzaminim citologjik,
  25. dana për biopsi,
  26. pajisje për dërgim të materialit biopsik në laborator,
  27. pajisjen për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur.
- c) Salla e operacionit përveç aparatit portabil të rëntgenit, pajisjet tjera janë të njëjta si në nenin 31.2 të këtij udhëzimi administrativ.
- d) Pajisjet për kujdes intensiv si në nenin 38.5 të këtij udhëzimi administrativ.
- e) Salla e lindjes për shërbimin e gjinekologjisë me obstetrikë duhet të ketë:
1. tavolinën për lindje,
  2. reflektor me mbajtës,
  3. monitor për EKG, TA dhe puls,
  4. kardiotokograf,
  5. tavolinë për reanimim të porsalindurit me pajisje,
  6. vakum aspirator elektrik,
  7. vakum ekstrator,
  8. komplet të forcepsave,
  9. llamba baktericide,
  10. aparati me oksigjen me pajisje,
  11. instrumentariumin për ekzaminim gjinekologjik dhe ekzaminimin të shtatzënave,

12. kolposkop,
13. aparat për ultrazë,
14. mikroskop,
15. amnioskop,
16. instrumentarium për HSG\*,
17. instrumente për ndërhyrje të vogla gjinekologjike dhe elektrokauter,
18. pajisjen për lindje normale,
19. instrumentariumin për kryerje operative të lindjeve anormale dhe patologjike,
20. vakum aspiratori,
21. instrumentariumin për laparotomi dhe për operacione vagjinale më të mëdha,
22. aparatën për anestezi intratrakeal,
23. kardiotokograf dhe detektor të rrahurave të zemrës së frytit.

f) Hapësira për reanimim dhe trajtim të porsalindurit:

1. peshorja për matjen e të porsalindurit,
2. vaskë për larjen e të porsalindurit,
3. vakum aspirator elektrik,
4. pompë infuzive,
5. pehametër digjital\*,
6. pajisjen për reanimim dhe trajtim të porsalindurit.

g) Neonatologjia duhet të përfshijë:

1. inkubator transporti,
2. inkubator për prematurët,
3. inkubator për kujdes standard,
4. shtrat për të porsalindurit,
5. karrocë për transportimin e të porsalindurit.

30.3 Personeli i njësisë obstetrike duhet të sigurojë në vazhdimësi shërbime 24 orë:

a) Përveç personelit të paraparë në nenin 8.2 të këtij udhëzimi administrativ, duhet të ketë edhe:

1. një pediatër-neonatolog ,
2. një specialist anesteziolog-reanimator dhe kujdes intensiv me personelin e sallës,
3. instrumentare,
4. një infermier asistent për lindoret me 500 lindje në vit e që rritet proporcionalisht prej numrit të lindjeve në vit.
5. infermiere mami,

b) Personeli i njësisë gjinekologjike:

1. Si në nenin 8 të këtij udhëzimi administrativ.

## Neni 31

### Shërbimi i kirurgjisë

- 31.1 Hapësira për shërbimin e kirurgjisë, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të këtij udhëzimi administrativ duhet të ketë edhe:
- sallat e operacioneve së pakut 20 m<sup>2</sup> (deri në 100 shtretër 3 salla dhe për çdo 50 shtretër shtesë plus një sallë),
  - klimatizim, ventilim, aspirim dhe oksigjenim qendror,
  - dhoma e veshjes,
  - dhoma e kujdesit gjysmë intensiv,
  - hapësira për ruajtjen e instrumenteve dhe furnizimeve të sterilizuara,
  - hapësira për larje duarsh para operacionit,
  - hapësira për pastrim-përgatitje preoperatore të pacientit,
  - hapësira për barela me rrota barelë,
  - dhoma e zgjimit nga anestezi,oni,
  - dhoma aseptike për përpunimin e plagëve të kontaminuar.
- 31.2 Pajisjet dhe inventari për shërbimin e kirurgjisë:
- Në dhomën e pranimit, përveç pajisjeve të përcaktuara në nenin 20.2 duhet të ketë edhe:
    - tavolinë për intervenime të vogla kirurgjike,
    - llambë lëvizëse,
    - vakum aspirator elektrik,
    - karrocë për transportimin e të sëmurëve të shtrirë,
    - dyshkallësh.
  - Në pjesën stacionare:
    - rektoskop,
    - pinceta kirurgjike dhe anatomike,
    - skalperë,
    - gërshërë kirurgjike,
    - gjilpëra kirurgjike dhe penj,
    - mbajtës të gjilpërës,
    - pajisje për kryerjen e intervenimeve kirurgjike të vogla me anestezi,ion lokal,
    - sonda,
    - kateter,

10. pajisje për punkcion dhe bllokadë lokale,
11. pajisje për anestezion lokal,
12. aspirator,
13. mbajtës të gjuhës,
14. mbajtësin e infuzionit,
15. aparat për dhënie të oksigjenit me bombole të oksigjenit,
16. setet për infuzione,
17. pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike- me sistem të mbyllur.

c) Salla e operacionit:

- 1.tavolinë kirurgjike,
- 2.llamba ndriçuese operative,
- 3.elektrokauter,
- 4.aspirator te fushës operative,
- 5.burimi i oksigjenit ,
- 6.kompleti i laringoskopëve,
- 7.ambu balon me maskë,
- 8.stetoskopi, tensimetri, puls-oksimetër,
- 9.aspiratori,
- 10.barërat për premedikim mjekësor, për anestezion të përgjithshëm, për anestezion lokal dhe regjional,
- 11.barërat për reanimim,
- 12.lidhëse,
